

Indeksi i Integritetit Politik ¹

Rasti #5 – Prokurorja publike Lençe Ristoska

Hyrje

Fokusi i kësaj analize është [vendimi](#) i prokurores publike Lençe Ristoska për të dhënë [dorëheqje](#) nga funksioni i prokurores publike. Analiza bazohet në informacione të disponueshme publikisht, raporte mediatike dhe [reagime](#) në publik lidhur me rrethanat që çuan në këtë vendim.

Dorëheqja vjen pas një sërë vendimesh institucionale: [përrjashtëmi i Ristoskës nga lëndët “Talir 1” dhe “Talir 2”](#) nga prokurori publik i shtetit, si dhe [refuzimi i iniciativës së saj para Këshillit të Prokurorëve Publikë](#), në të cilën ajo kishte theksuar [presione dhe cenim të pavarësisë së saj](#).

Për më tepër, ajo së fundmi ishte kandidatë për prokurore publike të shtetit, por nuk u zgjodh nga Qeveria. Në këtë kontekst, Ristoska shpjegon publikisht se nuk mund ta vazhdojë funksionin në përputhje me parimet e saj.

[Ristoska](#) është ish-anëtare e [Prokurorisë Speciale Publike](#), ku ka punuar në disa lëndë me profil të lartë, ndër të cilat “Talir 1”, “Talir 2” dhe “Target-Fortesa”. Pas shuarjes së PSP-së, ajo e vazhdoi karrierën në prokurorinë e rregullt, ndërsa paralelisht është e angazhuar edhe si prokurore publike për lidhje me [Eurojust-in](#).

Rasti hap pyetje për kushtet e punës në prokurori, shkallën e pavarësisë së prokurorëve dhe raportin mes integritetit personal dhe kontekstit institucional, duke ndikuar gjithashtu në perceptimin për integritetin e institucionit dhe besimin e qytetarëve.

Vlerësimi i integritetit politik

Kategoria: Sundimi i ligjit

Vlerësimi: “Ndërtuese e normave” (+9)

¹ [Metodologjia e “Indeksit të Integritetit Politik”](#).

Argumenti kryesor në këtë rast është përputhshmëria mes qëndrimeve të shprehura publikisht dhe vendimit të marrë. Ristoska tregon për kufizime në autonominë e saj profesionale, [presione politike](#) dhe pamundësi për të vepruar sipas parimeve të saj, pas së cilës pason një hap konkret: tërheqja nga funksioni. Një konsistencë e tillë përfaqëson një tregues të qartë të integritetit personal dhe profesional.

Edhe pse ekzistojnë interpretime të kundërta politike (përfshirë vlerësime se ky veprim është i [motivuar politikisht](#)), ato nuk e ndryshojnë thelbësisht faktin se bëhet fjalë për një akt personal të tërheqjes nga funksioni në kushte mosmarrëveshjeje me mënyrën e funksionimit të sistemit.

Sipas metodologjisë së Indeksit, ky lloj veprimi, tërheqje nga funksioni në kushte mosmarrëveshjeje me praktikën institucionale, vlerësohet si “**Ndërtuese e normave**”, sepse vendos një standard për sjellje të përgjegjshme në funksion publik.

Argumentet kryesore

- Prokurorja publike Lençe Ristoska jep dorëheqje duke e arsyetuar publikisht si rezultat i pamundësisë për të vepruar sipas standardeve profesionale.
- Reagime publike nga [ekspertë të fushës](#) e interpretojnë dorëheqjen si [akt integriteti dhe sinjal për probleme në sistem](#), përfshirë vlerësime se ajo përfaqëson një tregues indirekt të gjendjes në prokurori.
- Pas publikimit të dorëheqjes, vijnë reagime nga publiku, ekspertët dhe subjektet politike. Një pjesë e analizave e vlerësojnë si akt integriteti dhe tregues të problemeve sistematike në prokurori, ndërsa [VMRO-DPMNE](#) në pushtet e cilëson si të motivuar politikisht.
- Prokurori i shtetit Saveski, në reagimin e tij, shpreh [keqardhje për dorëheqjen](#), duke theksuar se vendimet e tij ndaj saj nuk janë të motivuara politikisht, por janë të [pavarura](#).

Rasti si shembull i integritetit

Rasti i Lençe Ristoskës përfaqëson një shembull të tërheqjes publike nga funksioni me arsyetim të bazuar në parime personale dhe profesionale.

Vendimi për dorëheqje përbën një akt konsistent në raport me qëndrimet e shprehura publikisht.

Brenda kornizës së Indeksit të Integritetit Politik, rasti klasifikohet si “Ndërtuese e normave” – pra një situatë ku ekziston përputhje mes parimeve dhe veprimeve, pavarësisht kontekstit kompleks institucional dhe politik.

Dokumenti është përgatitur nga Forumi për Politika të Arsyeshme (FPR) si pjesë e punës sonë afatgjatë për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e Indeksit të Integritetit Politik. Analiza bazohet në të dhëna publike të disponueshme në media dhe në kriteret e përcaktuara të [indeksit](#).